REPUBLIKA E KOSOVËS - REPUBLIKA KOSOVA
REPUBLIC OF KOSOVO
KOMUNA OBILIQ - OPŠTINA OBILIĆ - MUNICIPALITY OBILIC
Nr. Br. No. 01-060/01-33191/26
Nr. i fq. / Br.str. / No.pg.
Data / Datum / Date 16.10.2026
OBILIQ - OBILIĆ - OBILIC

REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA - REPUBLIC OF KOSOVO
KOMUNA E OBILIQIT
OPŠTINA OBILIĆ - MUNICIPALITY OF OBILIC

KUVENDI KOMUNAL OBILIQ
Skupština Opštine Obilić - Municipality Assembly Obiliq

EKSTRAKT I PROCESVERBALIT

Nga mbledhja e Komitetit për Politikë dhe Financa, të mbajtur me dt.25.09.2026, në ora 11:00 në sallën e Kuvendit Komunal.

Të pranishëm ishin: Sami Ahmeti, Fjolla Nasufi, Albanë Shillova Shalaku, Vlora Mjekiqi Kabashi, Labinot Mirena, Abdyrrahman Krasniqi dhe Dorentina Krasniqi

Të pranishëm të tjerë: Kryetari Komunës z.Halil Thaçi, drejtorët komunal e tjerë

Mbledhjen e udhëhoqi Sami Ahmeti, kryesues i cili pasi konstatoi se ka kuorum filloi mbledhjen me këtë:

REND DITE

1. Arsyetimi për mungesë
2. Miratimi i ekstraktit të procesverbalit nga mbledhja e kaluar e KPF-së, e mbajtur me dt.28.08.2026
3. Shqyrtimi dhe miratimi i Planifikimit të Buxhetit për vitin 2027 dhe parashikimet për vitet 2028-2029
4. Shqyrtimi i Propozimvendimit për caktimin e normave tatimore për vitin 2027
5. Shqyrtimi i kërkesës së Drejtores së Drejtorisë të Arsimit me nr.10-104-02-28241-26, dt.11.09.2026 për regjistrimin e Pronës Shoqërore Shkolla Fillore "Vllaznimi" në emër të Komunës së Obiliqit
6. Shqyrtimi i Raportit të Performancës Komunale për vitin 2025
7. Shqyrtimi i kërkesës së drejtorit të DPUKP-së me nr.05-104/02-28767/26, dt.16.09.2026 për shqyrtimin e Raportit për Monitorimin e Kontratave të Pronave të dhëna në shfrytëzim
8. Shqyrtimi i kërkesës me nr.01-070/05-0027911/26, dt.10.09.2026 për mbështetje dhe financim të projektit "Mbështetja dhe zhvillimi i fermerëve me lopë qumështore"
9. Shqyrtimi i kërkesës me nr.02-020/01-28856/26, dt.17.09.2026 për miratimin e Planit të Veprimit për Transparencë Komunale 2026-2030
10. Shqyrtimi i kërkesës me nr.02-020/01-28856/26, dt.17.09.2026 për miratimin e Rregullores për Transparencë të Komunës së Obiliqit
11. Të ndryshme

Kryesuesi– I njoftoi të pranishmit me rendin e ditës, i cili u miratua me 7 vota për.

Pika 1 e rendit të ditës

Të gjithë anëtarët ishin të pranishëm.

Pika 2 e rendit të ditës

Miratohet ekstrakti i procesverbalit nga mbledhja e kaluar me 7 vota për.

Pika 3 e rendit të ditës

Kryesuesi – Paraqiti shqyrtimin dhe miratimin e Planifikimit të Buxhetit për vitin 2027 dhe parashikimet për vitet 2028-2029.

Besnik Krasniqi – Sa i përket planifikimit të buxhetit, të gjitha seancat janë mbajtur me qytetarë ashtu edhe qysh parashihet, ju materialin e keni dhe unë propozoj që të i'a rekomandojmë Kuvendit për miratim.

Fjolla Nasufi – Pasi që materialin veç e kemi dhe drejtori tha se kaë kaluar të gjitha fazat vetëm na mbetet t'i rekomandohet Kuvendit Komunal.
Vlora Mjekiqi Kabashi – Drejtori e potencoi se e kemi materialin po ashtu, e potencoi se janë mbajtë të gjitha debatet dhe së fundi është mbajtë edhe një vetëm kisha dashtë me ditë nëse, ka ndonjë ndryshim prej debateve, apo ka pasë ndonjë kërkesë që është përfshirë në buxhet. Përndryshe, jemi në rregullë.
Besnik Krasniqi – Kërkesa ka pasë dhe i kemi shqyrtue ato kërkesa rreth buxhetit, që besoj se materialin me ndryshime do t' ua përcjellë për mbledhjen e Kuvendit.
Kryesuesi - Është shumë e rëndësishme nëse, ka pasë inkorporime të kërkesave të qytetarëve të na tregoni a ka pasë ndryshime, ku ka qenë interesimi i qytetarëve dhe a janë inkorporue ato gjëra.
Pas diskutimeve, anëtarët e Komitetit për Politikë dhe Financa me 7 vota për, i'a rekomanduan Kuvendit Komunal të shqyrtoj dhe të miratojë Planifikimin e Buxhetit për vitin 2027 dhe parashikimet për vitet 2028-2029.

Pika 4 e rendit të ditës

Kryesuesi – Paraqiti shqyrtimin e Propozimvendimit për caktimin e normave tatimore për vitin 2027.
Besnik Krasniqi – Ashtu siç është e paraparë edhe në material këto norma janë norma më të ulëta në nivel të vendit. Nëse, ka ndonjë ndryshim këto zakonisht nuk bëhen prej nesh, por caktohen nga Ministria e linjës.
Fjolla Nasufi – Ne jemi dakord që ti rekomandohet Kuvendit Komunal.
Vlora Mjekiqi Kabashi – Ne nuk kemi asgjë pasi që këto, veç janë të caktuara me ligj dhe nuk mund ti ndryshoj askush, kështu që është në rregullë.
Pas diskutimeve, anëtarët e Komitetit për Politikë dhe Financa me 7 vota për, i'a rekomanduan Kuvendit Komunal të shqyrtoj dhe të miratojë Propozimvendimin për caktimin e normave tatimore për vitin 2027.

Pika 5 e rendit të ditës

Kryesuesi – Paraqiti shqyrtimin e kërkesës së Drejtorisë të Arsimit me nr.10-104-02-28241-26, dt.11.09.2026 për regjistrimin e Pronës Shoqërore Shkolla Fillore "Vllaznimi" në emër të Komunës së Obiliqit. Unë jam interesuar pak për shkak se me iu dhënë shpejgim në rast se nuk do të ishte drejtoresha në sallë dhe me aq sa kam kuptue kjo shkollë më nuk ekziston.
Sevdije Krasniqi – Shkolla në fjalë ashu siç e potencuat ju faktikisht nuk ekziston si objekt, kështu që ne i'a rekomandojmë Kuvendit Komunal si pikë të rendit të ditës, që të shqyrtohet dhe të merret vendim që këto parcela të regjistrohen në emër të Komunës.
Fjolla Nasufi – Unë nuk kam hyrë me hulumtue për numërin të parcelës, por kisha dashtë me ditë përafërsisht se ku gjendet si pronë, në cilën zonë.
Sevdije Krasniqi – Ju vetëm kërkesën e keni marrë dhe sipas informacionit pak që kemi kanë ekzistue dy baraka te parkingu ku janë te banesat e Hades, por tash ato dy baraka nuk ekzistojnë fare.
Pas diskutimeve, anëtarët e Komitetit për Politikë dhe Financa me 7 vota për, i'a rekomanduan Kuvendit Komunal të shqyrtoj dhe të miratojë kërkesën e Drejtores së Drejtorisë të Arsimit me nr.10-104-02-28241-26, dt.11.09.2026 për regjistrimin e Pronës Shoqërore Shkolla Fillore "Vllaznimi" në emër të Komunës së Obiliqit.

Pika 6 e rendit të ditës

Kryesuesi – Paraqiti shqyrtimin e Raportit të Performancës Komunale për vitin 2025. Kërkesa na ka ardhur prej drejtoreshës së administratës dhe është një material mjaft voluminoz.
Ariana Grajqevci – Siç e ceku edhe kryesuesi ju materialin e keni marrë, do të thotë ka ardhë raporti final për performancën komunale. Ky raport është për periudhën janar-dhjetor 2025 në të cilin paraqitet puna dhe rezultati komplet i Komunës. Në mënyrë të përgjithshme ky raport na jepë një pasqyrë të qartë të bëra në fusha të ndryshme në shërbime që Komuna i ka ofruar gjatë vitit 2025. Qëllimi kryesori i këtij raporti është që ta kemi një pasqyrë të qartë se ku duhet të përmirësohet dhe në cilat pika kemi dalë pak më keq. Ne jemi duke punuar vazhdimisht në këtë punë dhe po presim që në vitin 2026 të kemi një rezultat sa më të mirë.
Kryesuesi – Siç e dini raportet nuk votohen, por është mirë të kemi raporte sa më të shpeshta çka do që janë obligative dhe që qytetarët ta dinë çka po bëhet dhe qysh po bëhet.

Pas diskutimeve, anëtarët e Komitetit për Politikë dhe Financa me 7 vota për, i'a rekomanduan Kuvendit Komunal të shqyrtoj Raportin e Performancës Komunale për vitin 2025.

Pika 7 e rendit të ditës

Kryesuesi – Paraqiti shqyrtimin e kërkesës së drejtorit të DPUKP-së, për shqyrtimin e Raportit për Monitorimin e Kontratave të Pronave të dhëna në shfrytëzim. Ky është obligim ligjor që zakonisht dy herë në vit bëhet raport prej Komisionit të posaqëm për këtë fushë lidhur me këto prona që janë dhënë përgjatë gjithë këtyre viteve. Raporti është i mirëseardhur dhe sa e pashë unë në material janë dy raporte për shkak të mungesës së raportit të vitit të kaluar në fillim kur ka ndryshue pushteti.

Labinot Mirena – Unë sa kam mund me pa raportin që është për pronë atje, ka një mospërputhje me raportet e viteve të kaluara kryesues, që neve na janë sjellë si asambleistë.

Kryesuesi - Po pa dashtë me përdorë dozë kritike apo jo, në fillim sa kam marrë informacion Komisioni ka hezitu me pasqyruar në letër realitetin sepse përgjatë shumë kohësh dhe siç e kemi cekë në Kuvend këtu, të paktën unë kam qenë gjithë kritik ndaj këtyre raporteve për arsye se kam pasur përshtypje se nuk e kanë pasqyrue realitetin në terren. Kësaj radhe raporti i fundit që është bërë, mua më kanë garantue se është njëqind përqind i saktë qysh është në terren, pa marrë parasysh shpërputhjeve me ato qysh kanë qenë më heret. Unë i kam kërkuar drejtorit për informacionin e juaj të vijë me rekomandime se çka po bëjmë me ato parcela që nuk kanë arritë të zhvillojnë biznesin për çka edhe janë marrë. Në seancë të Kuvendit, do të jetë drejtori dhe sigurisht se do të kemi debat për këto çështje

Pas diskutimeve, anëtarët e Komitetit për Politikë dhe Financa me 7 vota për, ia rekomanduan Kuvendit Komunal të shqyrtoj Raportin për Monitorimin e Kontratave të Pronave të dhëna në shfrytëzim.

Pika 8 e rendit të ditës

Kryesuesi - Paraqiti kërkesën për mbështetje dhe financim të projektit "Mbështetja dhe zhvillimi i fermerëve me lopë qumështore". Kjo kërkesë nuk ka të bëjë me Kuvendin, por ne do të i'a rekomandojmë Drejtorisë së bujqësisë për shqyrtim dhe e lus drejtorin që në seancat vijuese ose në raport me kërkuesin ta bëjë një përgjigje për këtë çështje.

Selim Asllani – Ne do ta shqyrtojmë kërkesën dhe t'u kthejmë përgjigjen në seancën e Kuvendit.

Anëtarët e Komitetit për Politikë dhe Financa me 7 vota për, i'a rekomanduan Drejtorisë së bujqësisë shqyrtimin e kërkesës për mbështetje dhe financim të projektit "Mbështetja dhe zhvillimi i fermerëve me lopë qumështore".

Pika 9 e rendit të ditës

Kryesuesi – Paraqiti kërkesën për miratimin e Planit të Veprimit për Transparencë Komunale 2026-2030. Në seancën e fundit të Kuvendit të Komunës, ne i kemi dhënë pëlqimin që ky plan të dalë në debat publik dhe duke pasë parasysh se e kemi raportin se janë kryer debatet e nevojshme publike, ne mund të ia rekomandojmë Kuvendit këtë plan për shqyrtim dhe miratim.

Pas diskutimeve, anëtarët e Komitetit për Politikë dhe Financa me 7 vota për, ia rekomanduan Kuvendit Komunal të shqyrtoj dhe miratoj Planin e Veprimit për Transparencë Komunale 2026-2030.

Pika 10 e rendit të ditës

Kryesuesi – Paraqiti shqyrtimin e kërkesës për miratimin e Rregullores për Transparencë të Komunës së Obiliqit. Është e njejta edhe për këtë Rregullore e kemi dhënë pëlqimin për debat publik dhe tash pas kryerjes së procedurave propozoj që ti rekomandohet Kuvendit për shqyrtim dhe miratim.

Pas diskutimeve, anëtarët e Komitetit për Politikë dhe Financa me 7 vota për, ia rekomanduan Kuvendit Komunal të shqyrtoj dhe miratoj Rregulloren për Transparencë të Komunës së Obiliqit.

Kryesuesi – Pasi që juve iu ka ardhur materiali për mbledhje ka ardhur edhe një kërkesë nga DSHMS për fëmijët me sindromin down, çrregullime në zhvillim dhe forma të tjera të aftësisë së kufizuar.

Albertina Dedinca – Ne si Drejtori e shëndetësisë propozojmë mbështetjen financiare mujore në shumën prej 100 euro, për fëmijët me nevoja të veçanta, përfshirë fëmijët me sindromin down, qrregullime në zhvillim, autizëm dhe format e tjera të aftësisë së kufizuar. Kjo masë vjen si përgjegje ndaj nevojës së këtyre fëmijëve dhe familjeve të tyre, të cilat përballen me shpenzime të shumta të vazhdueshme për trajtime, terapi, barna, kontrollë dhe shërbime të nevojshme për zhvillimin dhe mirëqenien e këtyre fëmijëve. Me këtë masë synojmë të ofrojmë mbështetje konkrete, të rregulltë, dinjitoze për familjet, jetën

dhe mirëqenien e këtyre fëmijëve, andaj para jush kërkoj që ta shqyrtoni dhe ta rekomandoni për seancën e ardhshme të Kuvendit

Vlora Mjekiqi Kabashi – E nderuara drejtoreshë, unë ju përgëzoj për këtë iniciativë sepse mund të flas nga ana e mësimdhënëses, që i di saktësisht vështirësitë e prindërve dhe shpenzimet e tyre në lidhje me këta fëmijë. Vetëm e di se kjo kosto është minimale, nuk është e mjaftueshme, por ju e keni potencuar edhe e kuptoj buxhetin komunal se varësisht prej mundësive ju do ta rritni këtë mbështetje. Mirëpo, kisha dashtë të dijë se këta 87 fëmijë në Komunën e Obiliqit, a është numri i saktë sepse nuk është mirë ndoshta me harru ndonjë por me hulumtu që të jenë të gjithë të përfshirë, përndryshe ju përgëzoj për këtë iniciativë.

Fjolla Nasufi – Ne jemi pro kësaj iniciative dhe çdo iniciativë e mirë që vjen në favor të banorëve të Obiliqit, jemi gjithë për me përkrahë.

Abdyrrahman Krasniqi – Kryesues sa e di unë meqë, është drejtoresha e arsimit këtu, Komuna iu ka nda bursa nëse, nuk gaboj deri në 900 euro, për këto familje. Meqë ka ardhë puna kështu, unë e përgëzoj drejtoreshën për këtë iniciativë dhe ndoshta, kishte me qenë mirë me mbledhë edhe atë buxhetin që ka qenë te Drejtoria e Arsimit që të paktën me bë 200 euro mujor. Nëse, ata i marrin 900 euro, 800 apo 700 euro, deri në 1,000 euro dikund ka qenë vlera, këtë të hyrën mujore që e ka propozue drejtoresha edhe atë me marrë këndej e t'i bëjë 200 euro sepse vërtetë, ne po i shohim shtrenjtimet dhe sfidat jetësore, e ata kanë probleme në këtë drejtim.

Albertina Dedinca – Znj.Mjekiqi, këtë numër e kam marrë në Qendrën për Punë Sociale që figurojnë si të regjistruar 87 fëmijë që kanë fituar statusin prej Ministrisë së familjes dhe më kanë thënë se edhe 8 raste tjera, janë në process të verifikimit të fitimit ose mosfitimit të statusit. Prandaj, kushdo që ekziston në listën në Qendrën për Punë scociale, që është kriteri i parë banor i Obiliqit, i dyti fëmijë dhe i treti që ka ndonjërën prej atyre qrregullimeve që i përmenda ka me qenë përfitues.

Vlora Mjekiqi Kabashi – Ashtu, siç thashë edhe më heret po flas nga këndi i mësimdhënëses, se shumë prindë janë të prirur ti fshehin këto fakte reale. Mirëpo shpresoj shumë se kjo shumë minimale ti inkurajoj të gjitha familjet që të paktën të paraqiten në Qendrën për Punë Sociale, ti regjistrojnë fëmijët që të fillojnë të përfitojnë dhe të fillojnë të merren institucionet përkatëse me fëmijët të cilët ende janë në shtëpitë e tyre dhe nuk janë të evdientuar.

Sevdije Krasniqi – Ju informoj se ne si Drejtori e Arsimit, kemi filluar vlerësimin e nxënësve nëpër shkolla dhe deri më tani në shkollën "Ibrahim Rugova" e kemi bërë vlerësimin e 26 fëmijëve dhe ajo tabuja për fshehjen ka qenë e vërtetë. Mirëpo, tani e tutje besoj se prindët e kanë kuptue se duhet ta bëjmë një gjë të tillë dhe nuk po hezitojnë që të bëhet vlerësimi i fëmijëve.

Abdyrrahman Krasniqi – Drejtoreshë, a ka me qenë me shpallje publike apo qysh sepse nëse, është me shpallje publike edhe nëse, dikush nuk është i regjistruar aplikon.

Albertina Dedinca – Një prej arsyeve është edhe ideja se shumë prindër vijnë në zyre dhe nuk e dinë realisht çfarë duhet të bëjnë. Thonë; E kam dërguar fëmijën te logopedi, më ka thënë se ka autizëm ose ndonjë
çrregullim tjetër dhe çka duhet bërë mëtutje. Unë e referoj te Qendra për Punë Sociale dhe mendoj se kjo masë ka me i nxitë edhe të tjerët se shuma prej 100 eurove, është një nismë fillestare sado e vogël që me mund, sidomos te fëmijët që janë ende në çerdhe me ndërhy sa më heret sepse ndërhyrja e hershme jepë rezultate më të mira. Ne këtë po mundohemi me bërë si Drejtori dhe si Komunë.

Vlora Mjekiqi Kabashi – Duke ditur se që nga mosha 5 vjeçare fillojnë fëmijët në parashkollor dhe edhe nëse, rritet ky numër nuk do të thotë se është numër real sepse ka fëmijë deri në moshën 5 vjeçare, të cilët janë ende në shtëpi dhe nuk e dijnë institucionet që janë me autizëm. Prandaj, e potencova se është mirë kjo shumë sado minimale që është ndoshta, i inkurajon ata prindë të aplikojnë dhe të lajmërohen në Qendrën për Punë Sociale.

Pas diskutimeve, anëtarët e Komitetit për Politikë dhe Financa me 7 vota për, ia rekomanduan Kuvendit komunal kërkesën nga DSHMS për mbështetje financiare fëmijët me sindromin down, qrregullime në zhvillim dhe forma të tjera të aftësisë së kufizuar.

Kryesuesi – Paraqiti kërkesën nga MAPL për shfuqizimin e vendimit me nr.01-060/01-26950/26 për shpalljen me interes të përgjithshëm të pjesës së ngastrës kadastrale ZK Obiliq.

Vlora Mjekiqi Kabashi – Kryesues, po e pres fundvitin dhe mendoj se e meritoj një kërkim falje prej teje sepse ju e dini se çka më keni bërë vitin e parë, por nuk kam pasë kaq vendime.
Kryesuesi - Unë jam kritik vetë, por duhet ta keni parasysh se këto vendime i bjen Ekzekutivi, drejtorët që paraprakisht do të duhej ta shqyrtonin ligjin bukur mirë mirëpo, nganjëherë edhe MAPL-ja po përdorë standarde të ndryshme; për një Komunë një vendim i ngjajshëm për Komunën tjetër pozitiv për disa Komuna tjera negativ. Unë nuk e di nuk jam për me u përzie në punët e tyre, por duhet ta rekomandojmë për shfuqizim në seancë të Kuvendit.
Labinot Mirena – Pyeti se a është kërkesa për ndryshim të rrugës prej operatorit, apo prej Komunës.
Kryesuesi – Përgjegjet prej të dyjave.
Abdyrrahman Krasniqi – Fillimisht për t'u bërë një ndërrim i pronës nëse, nuk është interes i banorëve, ose qytetarëve nëse nuk ka nënshkrime atëherë duhet të bëhet vlerësimi i pronës së operatorit privat dhe vlerësimi i pronës komunale. Këto, ndryshime zakonisht bëhen kur ka Komuna interes, e jo operatori. Nëse, Komuna ka interes ne e votojmë, e jo në këtë rast vjen kërkesa e operatorit dhe Komuna e jepë pronën e vetë dhe e rregullon. Mirëpo, siç po thotë z.Labinot ne e kemi pozitivitetin dhe po i votojmë gjërat sepse logjikisht shkon Ministria e financave e vlerëson pronën, e pranon ndryshimin apo nuk e pranon atëherë e ndalon në fillim.
Kryesuesi – Znj.Vlora më ka dhënë afat deri në fund të vitit për me kërkue falje. Neve, na duhet të shfuqizojmë këtë vendim dhe vendimin vijues për shkak se nuk jemi për t'i bërë shkelje ligjore.
Pas diskutimeve, anëtarët e Komitetit për Politikë dhe Financa me 6 vota për, dhe 1 abstenim ia rekomanduan Kuvendit të Komunës shfuqizimin e vendimit me nr.01-060/01-26950 për shpalljen me interes të përgjithshëm të pjesës së ngastrës kadastrale P- 72614055-02040-0 ZK Obiliq me qëllim të këmbimit me pjesën nga ngastra kadastrale P-72614055-01448-27, ZK Obiliq.
Kryesuesi - Paraqiti kërkesën nga MAPL për shfuqizimin e vendimit me nr.01-060/01-26990/26 për shpalljen me interes të përgjithshëm të pjesës së ngastrës kadastrale ZK Plemetin.
Anëtarët e Komitetit për Politikë dhe Financa me 7 vota për, i'a rekomanduan Kuvendit të Komunës shfuqizimin e vendimit me nr. .01-060/01-26990/26 shpalljen me interes të përgjithshëm të pjesës së ngastrës kadastrale ZK Plemetin.
Pika 11 e rendit të ditës
Labinot Mirena – Unë e kam një kërkesë nga banorët e fshatit Baimoc, të cilët shesin speca do të thotë janë bujqë të Komunës tonë dhe bujqit e Komunave tjera që dalin në pjesën e territorit tonë prej Baimocit deri në Milloshevë, në njëfarë mënyre iu bëjnë konkurencë atyre, ndërsa bujqit tonë nëpër Komunat tjera nuk iu lejohen me shitë diçka. Unë kam kontakte me bujqit e Baimocit, që mbjellin speca dhe nuk po munden me i shitë produktet e tyre. Mendoj se është mirë Drejtoria e inspeksionit dhe Drejtoria e bujqësisë të merren me këtë çështje, se kjo verë shkoi por për verën e ardhshme mos ti kenë këto telashe qysh i kanë pasë në këtë vit.
Kryesuesi - Unë jam shumë i informuar për këtë çështje dhe drejtori i inspeksionit më ka thënë disa herë se kemi qenë dhe i kemi bërë fletëparaqitjet ndaj personave që kanë të bëjnë me këtë pjesë. Mirëpo, edhe si kërkesë do ta përcjelli te Drejtoria e inspeksionit dhe te Drejtoria e bujqësisë, që me dalë me një plan për vitet e ardhshme pa marrë parasysh edhe pse mund të jetë ekzistenciale për dikend, unë për vete nuk jam dakord të shiten produktet ushqimore në rrathë të qytetit, ose të fshatrave sepse vetëm të shëndetshme ato nuk janë. Ne iu shërbejmë qytetarëve, bizneseve dhe komunitetit prej të cilit jemi votue dhe nuk kemi nevojë me pasë shumë tolerancë ndaj qytetarëve të Komunave tjera, të cilët iu bëjnë konkurencë qytetarëve tonë, kështu që jam plotësisht dakord me atë që e thatë ju.

Mbledhja përfundoi në ora 11:47'

Zyrtare e lartë për punë të KK

Azize Zeneli

Kryesues i Komitetit

Sami Ahmeti